

DIPLOMACIA E SHQIPTAR GJATË VITEVE 1945-1961

TEMA PËR TITULLIN MASTER I HISTORISË KOHË E RE

NGA

QUN TOPLANAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

PRISHTINË, MARS, 2023

REZYME E TEMËS SË DIPLOMËS PËR NIVELIN MASTER

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Nuri Bexheti

Kandiati: Qun Toplanaj

Tema: Diplomacia e shtetit shqiptar gjatë viteve 1945-1961

Qëllimi i këtij studimi është trajtimi i temës: “Diplomacia e shtetit shqiptar gjatë viteve 1945-1961”, dhe synimi për të paraqitur një pasqyrë të qartë të zhvillimit diplomatik të shtetit shqiptar gjatë mbarimit të Luftës së Dytë Botërore e deri më 1961. Janë shtjelluar në mënyrë të duhur marrëdhëniet me shtetet fqinje dhe perëndimore gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941-1944) dhe pas mbarimit të saj (1945-1961), si në aspektin politike, ushtarak, ekonomik e diplomatike siç janë: konferencat gjatë viteve 1942-43, roli i Partisë Komuniste Jugosllave (PKJ) dhe misionarëve perëndimorë gjatë Luftës së Dytë Botërore, dhe marrëveshjet ekonomike me Jugosllavinë (1945-47), me Bashkimin Sovjetik (1949-59) dhe me Kinën komuniste (1954-60).

Në fillim të këtij punimi është bërë grumbullimi i literaturës adekuate dhe janë bërë hulumtime të tjera lidhur me literaturën relevante për temën bosht të çështjes së shtruar për studim. Ndërsa më pas ka ndodhur strukturimi i temës, e që në këtë aspekt, tema është e ndarë në 4 kapituj dhe në disa nënkapituj të cilave u paraprijnë: abstrakti, shkurtesa dhe hyrja.

Kapitujt kanë këtë përmbajtje strukturore:

1. Në kapitullin e parë të titulluar: "MARRËDHËIET E PKSH ME PKJ DHE MISIONET PERËNDIMORE" është trajtuar ndikimi i PKJ-së mbi formimin e PKSH-së, ndërhyrja e saj në vendimet politike në Kongresin e Pezës, Labinotit, Mukjes, dhe roli i emisarëve jugosllav mbi organizimin e LNC-së, themilimi i Sigurimit nga këshilltarët jugosllav etj. Përveç kësaj flasim edhe për ardhjen e misionarëve perëndimor në Shqipëri. Roli i tyre ishte që të bashkonte grupet e ndryshme shqiptare për të luftuar nazi-fashizmin, të furnizonin me armë etj.

2. Në kapitullin e dytë të titulluar: "DIPLOMACIA SHQIPTARE PAS PËRFUNDIMIT TË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE" janë trajtuar një sërë çështjesh që nga vendosja e marrëdhënieve jo zyrtare me qeveritë perëndimore më 1945 e deri me ndërprerjen me të (1947); konflikti diplomatik me Britaninë (incidenti i kanalit të Korfuzit) më 1946 i cili vazhdoi deri më 1949 me fitoren diplomatike të britanisë; dhe qëndrimi i shtetit shqipëtar ndaj çështjes së Kosovës.
3. Në kapitullin e tretë të titulluar: "DIPLOMACIA SHQIPTARE NDAJ SHTETËVE FQINJE (1945-1948)" janë trajtuar marrëdhëniet me shtetet fqinjë, roli i tyre negativ dhe pozitiv, marrëveshjet ekonomike e politike dhe ndikimi i shtetit jugosllav në Shqipëri e deri në prishjen e marrëdhënieve me të; bisedimet me Italin dhe me Greqin në Konferencën e Paqës së Parisit 1946 dhe problemi i marrëdhënieve me shtetin grek (1945-49), roli i Shqipërisë dhe vendëve komuniste në luftën civile greke.
4. Në kapitullin e katërt të titulluar: "POZITA NDËRKOMBËARE E SHQIPËRISË GJATË VITEVE 1948-1961", kam paraqitur qëllimin e operacionit sekret për rrëzimin e Enver Hoxhës dhe arsyet e dështimit të tij; dhe në vazhdim marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik, marrëveshjet ekonomike e ushtarake, dhe arsyet e prishjes me të; dhe në fund janë paraqitur marrëdhëniet shqiptaro-kineze, raporti i tyre me Bashkimin Sovjetik dhe me Jugosllavinë dhe marrëveshjet ekonomike me Shqipërinë komuniste gjatë kësaj periudhe.

Në punimin e kësaj teme sa i përket metodave hulumtuese janë përdorur metodat kualitative dhe kuantitative. Ndërsa për të finalizuar temën janë përdorur metodat përshkruese, analitike dhe krahasimore. Gjithashtu për realizimin e këtij punimi janë shfrytëzuar një sërë burimesh arkivore të cilat janë marrë nga Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH), burime arkivore të botuara, punime shkencore, etj., të cilat më kanë ndihmuar në vërtetimin e hipotezave të ngritura, të cilat janë:

1. Themelimi i PKSH-së erdhi me ndihmën e PKJ-së dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, PKJ ndikojë në vendimet politike të PKSH-së.
2. Për prishjen e marrëdhënieve me perëndimin, ndikim kishte pasur Jugosllavia komuniste.

3. PKSH, për zgjidhjen e çështjes së Kosovës do t'i përmbahej parimeve të ideologjisë marksiste-leniniste dhe vendimeve të aleatëve të mëdhenj antifashist.

4. Arsyeya e prishjes me Jugosllavinë dhe Bashkimin Sovjetik ishte ruajtja e pushtetit të Enver Hoxhës.